

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 57271/14
Ndue MARKU
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 23 shtator 2025 si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Në lidhje me:

kërkesën (nr. 57271/14) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) më 8 gusht 2014 nga një shtetas shqiptar, z. Ndue Marku (kërkuesi), i cili ka lindur në vitin 1966, banon në Tiranë dhe u përfaqësua nga z. M. Gjoci, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar mbi ankesën, e bërë në mbështetje të nenit 7 të Konventës, qeverinë shqiptare (qeveria), përfaqësuar nga Agjenti i saj z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkuesi, i cili në atë periudhë ishte jurist në Ministrinë e Mbrojtjes, u dënua për shpërdorim të detyrës, në lidhje me shpërthimin në vitin 2008 në fabrikën e Gërdecit (shih *Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 63543/09 dhe 3 të tjerë, §§ 5–13, 7 nëntor 2023). Çështja ka të bëjë me parashikueshmërinë e dënimit të tij.

A. Konteksti

2. Në dhjetor 2006, një kompani amerikane, Southern Ammunition Company (SAC) shprehu interesin për të blerë dhe demontuar municionet e vjetra në Shqipëri. SAC-i paraqiti një ofertë për ndërmarrjen Military Export-Import Company (MEICO), një ndërmarrje shtetërore nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Kërkuesi, si drejtor në departamentin juridik të Ministrisë së Mbrojtjes, ishte pjesë e grupit të punës që kishte hartuar rregulloren për shitjen e municioneve me qëllim demontimin e tyre. Më 14 mars 2007, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 138, “Për procedurën e trajtimit të armëve, teknikës dhe pajisjeve të forcave të armatosura, të hequra nga armatimi dhe përdorimi” (vendimi nr. 138).

4. Vendimi nr. 138 rregullonte shitjen e municionit të kalibrit të vogël, me qëllim demontimin e tij (shih paragrafin 49 në vijim). MEICO-s iu besua drejtimi i procedurës së shitjes në raste të tilla, duke pasur në konsideratë eksperiencën e blerësit në demontimin dhe çmontimin e municioneve.

B. Kontrata e parë

5. Më 25 prill 2007, Ministri i Mbrojtjes lëshoi një urdhër ku e emëronte SAC-in si kontraktorin për procesin e demontimit.

6. Më 6 qershor 2007, MEICO dhe SAC-i nënshkruan kontratën e tyre të parë që kishte të bënte me municione të kalibrit nga 7.62 deri në 14.5 mm.

C. Kontrata e dytë dhe zhvillimet e mëpasshme

7. Më 1 shtator 2007, SAC-i paraqiti një ofertë të dytë pranë Ministrisë së Mbrojtjes për të lidhur një kontratë për municionet e kalibrit nga 20 deri në 152 mm.

8. Më 22 nëntor 2007, Kolonel. D. Ç., drejtor i Departamentit të Logjistikës Ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes, përgatiti një projekt-urdhër për t'u nënshkruar nga ministri i Mbrojtjes. Sipas projekt-urdhrit, municionet e kalibrit nga 20 deri në 152 mm do t'i shiteshin SAC-it me qëllim demontimin e tyre.

9. Projekt-urdhri më pas u miratua nga L. H., shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

10. Më 22 nëntor 2007, kërkuesi, juristi i Ministrisë së Mbrojtjes, e rishikoi projekt-urdhurin. Pasi ai nuk identifikoi asnjë problematikë juridike, kërkuesi vendosi inicialet e tij që tregonin se ai kishte kontrolluar pajtueshmërinë ligjore të dokumentit.

11. Më 7 dhjetor 2007, ministri i Mbrojtjes nënshkroi projekt-urdhurin, që u bë urdhri nr. 2044. Më 28 dhjetor 2007, MEICO nënshkroi një kontratë të dytë me SAC-in.

12. Më 15 mars 2008, rreth mesditës, në fabrikën e demontimit të armëve në Gërdec ndodhi një shpërthim i madh. Njëzet e gjashtë njerëz humbën jetën dhe rreth 300 të tjerë u lënduan.

D. Gjykimi

13. U ndërmorën procedura penale ndaj tridhjetë personave, duke përfshirë edhe kërkuesin.

14. Kërkuesi u akuzua për shpërdorim detyre në mbështetje të nenit 248 të Kodit Penal për shqyrtimin e projekt-urdhrit nga ana e tij.

1. Raporti i ekspertit ushtarak

15. Më 10 dhjetor 2008, prokurorët i kërkuan ekspertëve ushtarakë të përcaktonin nëse municioni që ishte dërguar për demontim në Gërdec ishte municion i kalibrit të vogël sipas parashikimit në vendimin nr. 138.

16. Më 10 shkurt 2009, ekspertët pohuan se kalibri nuk ishte brenda kriterëve të përdorura nga Forcat e Armatosura Shqiptare për kategorizimin e municionit. Në lidhje me këtë, termi “kalibër i vogël” i përdorur në vendimin nr. 138 nuk gjendej në dokumente të tjerë ushtarakë.

17. Ekspertët shtuan se ata kishin shqyrtuar një sërë manualesh trajnimi dhe literaturë shtesë që e klasifikonin municionin sipas kalibrit. Një botim rus i vitit 1956 përcaktonte se municioni i kalibrit deri në 70 mm ishte municion i kalibrit të vogël, ndërsa municioni i kalibrit midis 70 dhe 155 mm ishte municion i kalibrit të mesëm. Në një botim të vitit 1985, Forcat e Armatosura të Shqipërisë i referoheshin të njëjtit klasifikim.

2. Gjykata e Rrethit Tiranë

18. Kërkuesi e mohoi akuzën dhe pretendoi se përmbajtja e nenit 248 të Kodit Penal nuk e lejonte të parashikonte se cilat veprime ose mosveprime mund ta bënin atë me përgjegjësi penale.

19. Më 12 mars 2012, Gjykata e Rrethit Tiranë shpalli vendimin e saj me 573 faqe ku përfshihej një seksion për secilin të pandehur.

20. Mbështetur në raportet e ekspertëve, gjykata konstatoi se procedurat e përdorura në fabrikën e Gërdecit kishin qenë të pasigurta. E teksa arsyjeja e saktë për shkaktimin e zjarrit nuk mund të përcaktohej, sipas provave të mbledhura, ajo çfarë kishte probabilitet të kishte ndodhur ishte se punëtorët kishin qenë duke lëvizur shtytësit me një karro dore që sapo ishte riparuar me anë të teknikave të saldimit dhe që e kishte ruajtur ende nxehtësinë.

21. Sipas provave dhe argumenteve të shqyrtuara, gjykata e shpalli kërkuesin, të përfaqësuar nga një avokat, fajtor për akuzën e përfshirjes në përgatitjen e urdhrit nr. 2044. Ai u dënua me një vit burgim dhe u urdhërua të paguante një gjobë.

22. Gjykata përshkruante procesin e hartimit të urdhrit, siç edhe shpjegohet në paragrafët 8–11 më sipër, dhe iu referua kërkuetit si bashkautor i projekt-urdhrit, për shkak të faktit se ai kishte kontrolluar pajtueshmërinë juridike të dokumentit. Në vijim, gjykata arsyeton se të metat ligjore në urdhër i atribuoheshin të gjithë individëve të cilët kishin kontribuar në përgatitjen e tij, duke përfshirë kërkuetin.

23. Gjykata identifikoi mospajtueshmëritë e mëposhtme midis urdhrit dhe ligjit.

a) Kalibri

24. Vendimi nr. 138 parashikonte vetëm demontimin e municionit të kalibrit të vogël, ndërsa projekt-urdhri trajtonte edhe municionin e kalibrit të mesëm dhe të madh.

25. Gjykata i dha peshë të madhe faktit se kërkueti kishte qenë anëtar i grupit të punës që kishte hartuar vendimin nr. 138 (shih paragrafin 3 më sipër), dhe për pasojë ai nuk mund të mos kishte qenë në dijeni të përmbajtjes së tij.

26. Gjykata vlerëson se dallimi midis kalibrave të ndryshëm ishte bërë i qartë nga ekspertët, që kishin arritur në përfundimin në raportin e tyre se municioni i kalibrit mbi 70 mm nuk mund të klasifikohet si municion i kalibrit të vogël (shih paragrafët 15–17 më sipër).

b) Licencat, eksperiencia dhe pajisjet e kontraktorit

27. SAC-i nuk kishte një licencë për të realizuar demontimin e municionit të kalibrit të mesëm dhe të madh, siç kërkohej në rregulloren nr. 9603, të datës 18 shtator 2003, për importin dhe eksportin e pajisjeve ushtarake. Neni 3.1 i asaj rregulloreje e përkufizonte një licencë si “leje profesionale me shkrim që mund të tërhiqej, dhe që e lejonte mbajtësin e saj të kryente një ose më shumë aktivitete, në lidhje me eksportin dhe importin e armëve, municioneve, pajisjeve ushtarake dhe shpërndarjen dhe tregtimin e tyre”. Autorët e projekt-urdhrit, duke përfshirë kërkuetin, nuk i kishin kërkuar SAC-it të merrte licencën e kërkuar. Gjithashtu, ata nuk kishin kërkuar dokumentet që dëshmonin eksperiencën e mëparshme të kontraktorit, pajisjet që do të përdorehin, dhe pajtueshmërinë me kërkesat e sigurisë sipas nenit IV (3), të vendimit nr. 138 (shih paragrafin 49 në vijim).

3. Apelimi

28. Kërkueti u ankua dhe parashtroi se gjykata nuk kishte përcaktuar fushëveprimin e tij profesional dhe kufijtë e tij. Kërkueti ishte një nëpunës civil dhe jo një ushtarak, dhe detyra e tij kufizohej në dhënien e opinioneve juridike për projekt-instrumentet juridike që i dorëzoheshin Ministrisë së Mbrojtjes.

29. Siç deklarohet nga ekspertët, nuk ekzistonte asnjë instrument ligjor që përcaktonte se cili municion duhej të klasifikohet si municion i kalibrit të vogël, dhe gjykata më e ulët nuk kishte cituar ndonjë instrument të tillë juridik. Kjo çështje ishte e një natyre teknike dhe jo juridike, siç provohet nga fakti se prokurorët kishin urdhëruar realizimin e një raporti nga ekspertët për sqarimin e kësaj çështjeje.

30. Kërkueti parashtroi se gjykata më e ulët kishte gabuar kur i ishte referuar rregullores nr. 9603, e cila rregullonte importet dhe eksportet, për atë që procesi i demontimit kryhej brenda vendit. Gjithashtu, gjykata nuk kishte shpjeguar se përse ajo kishte vlerësuar se detyra e kërkuetit kishte qenë përcaktimi në projekt-urdhër i detyrimeve licencuese që gjendeshin gjatë.

31. Në po të njëjtën linjë, nuk i takonte kërkuetit të vlerësonte aspektet teknike, të tilla si eksperiencën e SAC-it, pajisjet që do të përdorehin apo se sa e këshillueshme ishte që të bëhej biznes me të.

32. Kërkueti shtoi se neni 248 i Kodit Penal, i cili parashikonte veprën e shpërdorimit të detyrës, ishte formuluar në mënyrë të paqartë dhe nuk pajtohej me nenin 7 të Konventës për faktin se ai ishte një dispozitë e përgjithshme që i referohej ligjeve të tjera për kualifikimin e veprës. Ai argumentoi se gjykata më e ulët e kishte shtrirë fushëveprimin e veprës në mënyrë të paarsyeshme, duke e bërë atë të paparashikueshme.

33. Kërkuesi parashtroi se dënimi i tij së bashku me oficerët ushtarakë ishte një gabim, pasi ai nuk kishte trajnim teknik ushtarak. Gjykata nuk e kishte individualizuar veprën. Si jurist, ai nuk kishte ekspertizën teknike për të vënë në pyetje specifikimet e përcaktuara nga ushtarakët, dhe nuk mund të vlerësonte lëndën e atyre vendimeve.

34. Kërkuesi shtoi se MEICO kishte angazhuar nëpunësin e vet juridik, dhe se ai nuk duhej të bëhej përgjegjës për punën e atij juristi.

35. Në fund, ai u shpreh se gjykata nuk kishte shpjeguar se cilat elemente e kishin çuar në përfundimin se kërkuesi kishte vepruar me qëllim kriminal në kryerjen e veprimeve dhe mosveprimeve për të cilat ai ishte dënuar.

4. Gjykata e Apelit Tiranë

36. Më 13 shkurt 2013, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi dënimin ndaj kërkuesit dhe dënimin e tij me burgim; megjithatë ajo shfuqizoi gjobën.

37. Në lidhje me Y. P., i cili ishte drejtori i MEICO-s, gjykata kundërshtoi akuzën e prokurorëve për vrasje. Ajo nuk gjeti asnjë indicie se i pandehuri kishte synuar të shkaktonte incidentin apo vdekjet. Gjykata e shpalli fajtor për “shkeljen e rregullave në lidhje me substancat shpërthyes, të djegshme ose radioaktive” dhe për shpërdorim të detyrës. Gjykata përdori një qasje identike për akuzat për vrasje ndaj një sërë të pandehurish të tjerë dhe për mungesën e “dashjes”.

38. Në lidhje me kërkuesin, në diskutimet e saj për veprën e shpërdorimit të detyrës, gjykata konstatoi se dashja ishte një element i nevojshëm.

39. Gjykata konstatoi se urdhri nr. 138 ishte i paligjshëm pasi ai nuk pajtohej me vendimin nr. 138, sepse ai lejonte demontimin e municioneve të një kalibri të caktuar për të cilin kontraktori nuk ishte as i pajisur dhe as i licencuar.

40. Gjykata e Apelit, ashtu si Gjykata e Rrethit, theksoi se kërkuesi kishte qenë anëtar i grupi të punës që kishte hartuar vendimin nr. 138, dhe në këtë mënyrë, ai nuk mund të mos kishte qenë në dijeni për përmbajtjen e tij. Ajo gjykoi se pasi nuk kishte respektuar vendimin nr. 138, kërkuesi kishte kontribuar në përzgjedhjen e një kontraktori të papërshtatshëm për procesin e demontimit.

41. Në lidhje me L. H, shefi i Stafit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe anëtar i grupit të punës në vendimin nr. 138, i cili po ashtu ishte akuzuar, gjykata vlerësoi:

“Procesi [i demontimit] i rregulluar nga [urdhri nr. 2044] i hartuar nga i akuzuari D. Ç, L. H., H. J. dhe [kërkuesi] është rreptësisht ushtarak, me elementet e duhura teknike, dhe për këtë arsye dhe për shkak të eksperiencës dhe njohurive të të akuzuarve, të cilët ishin oficerë të nivelit të lartë, [urdhri] duhej të ishte hartuar në një mënyrë të tillë që të reflektonte pa rrezik procesin e demontimit”.

42. Gjykata e Apelit konstatoi, gjithashtu, se “MEICO ishte ngarkuar me detyrën për të lidhur kontrata për kryerjen e operacioneve [të demontimit], duke bërë një vlerësim paraprak të kapaciteteve teknike dhe masave të sigurisë së procesit të demontimit”.

5. Gjykata e Lartë

43. Më 25 shkurt 2013, kërkuesi paraqiti një ankesë mbi pikat e ligjit, ku përsëriste argumentet e tij të mëparshme. Ai shtoi se Gjykata e Apelit kishte gjykuar se urdhri nr. 2044 ishte një instrument “rreptësisht ushtarak” me “elementet e duhura teknike” (shih paragrafin 41 më sipër), dhe përsëri e kishte dënuar atë – një jurist – për përmbajtjen e tij.

44. Gjithashtu, kërkuesi parashtroi se Gjykata e Apelit kishte deklaruar qartazi se vlerësimi i kapaciteteve dhe masave të sigurisë së procesit të demontimit (shih paragrafin 42 më sipër) kishin qenë detyra të MEICO-s, dhe sidoqoftë ajo e kishte dënuar atë për mosrealizimin e këtyre veprimeve.

45. Në fund, ai u ankua se Gjykata e Apelit kishte theksuar se dashja ishte një element i nevojshëm i veprës (shih paragrafin 38 më sipër) dhe përsëri nuk kishte shpjeguar se përse kishte arritur në përfundimin se kërkuesi kishte vepruar me dashje kriminale, teksa konstatonte, gjithashtu, se shpërthimi kishte qenë i paqëllimshëm (shih paragrafin 37 më sipër).

46. Më 19 korrik 2013, Gjykata e Lartë e rrëzoi ankesën e kërkuarit pasi ajo nuk mbështetej në arsye që ishin nën juridiksionin e saj.

47. Më 23 janar 2014, Gjykata Kushtetuese rrëzoi apelimin e kërkuarit, duke mos konstatuar shkelje të parimit *nulla poena sine lege*.

LIGJI PËRKATËS VENDAS

A. Kodi Penal

48. Neni 248 i Kodit Penal, në fuqi në periudhën konkrete, parashikon si në vijim:

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet burgim dhe një gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.”

B. Vendimi nr. 138 i Këshillit të Ministrave

49. Kapitulli IV, i vendimit nr. 138 të Këshillit të Ministrave, për sa ka të bëjë me çështjen, parashikon si në vijim:

“1. Ministria e Mbrojtjes, në funksion të reduktimit të stokeve të vjetëruara të municioneve të kalibrit të vogël, të nxjerra nga përdorimi e armatimi, mund të realizojë shitje për qëllim çmontimi dhe çmilitarizimi. Ky proces përfshin shitjen e municionit, mbikëqyrjen e procesit të çmilitarizimit dhe çmontimit të municioneve dhe të nënprodukteve, të rrjedhura prej tyre...”

3. Procedurat e shitjes së municionit për çmontim dhe çmilitarizim kryhen nga ndërmarrja MEICO, në bazë të kontratave. Në lidhjen e kontratave me subjekte të ndryshme të mbahen parasysh: përvoja e ofertuesit në fushën e armatim-municioneve, kapacitetet teknike, lloji i teknologjisë së përdorur në procesin e çmilitarizimit e çmontimit, afatet, ndikimi në mjedis, respektimi i masave të sigurisë gjatë procesit të çmilitarizimit e të çmontimit dhe çmimet e ...”.

VLERËSIMI I GJYKATËS

50. Kërkuari u ankua në mbështetje të nenit 7 të Konventës se ai nuk mund të kishte parashikuar se do të do të mbante përgjegjësi penale për arsye se kishte rishikuar ligjshmërinë e projekt-urdhrit nr. 2044.

51. Qeveria nuk ra dakord.

52. Parimet përkatëse së fundmi janë përmbledhur në çështjen *Saakashvili kundër Gjeorgjisë* (nr. 6232/20 dhe 22394/20, §§ 141–43, 23 maj 2024).

53. Gjykata tashmë ka vlerësuar se në rastin kur ka jetë të humbura në kontekstin e aktiviteteve të rrezikshme që potencialisht përfshijnë përgjegjësinë e shtetit, mund të ketë raste përjashtimore ku është i nevojshëm një hetim penal efikas për të përmbushur detyrimin procedural të parashikuar në nenin 2. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se për sa i përket incidentit në Gërdec, hetimi penal ishte i përshtatshëm për faktin se në përgjithësi ai arriti me sukses që të përcaktonte rrethanat e incidentit dhe të identifikonte personat përgjegjës për të (shih *Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 63543/09 dhe 3 të tjerë, §§ 183–204, 7 nëntor 2023).

54. Përgjegjësia penale e kërkuarit, siç gjykohet nga Gjykata e Apelit, qëndronte në përfshirjen e tij si këshilltar juridik në Ministrinë e Mbrojtjes për hartimin e urdhrit që autorizonte SAC-in të merrej me municionin që nuk ishte i një kalibri të vogël, dhe për të cilin kompania nuk kishte licencat, pajisjet apo ekspertizën e duhur. Së pari, në kundërshtim me parashtrimet e kërkuarit, të dyja problematikat ngrinin çështjet e ligjshmërisë dhe nuk ishin tërësisht të natyrës teknike. As fakti se autoritetet vendase kishin emëruar ekspertë ushtarakë për të shqyrtuar problematikën e parë, dhe as përgjigjet e ekspertëve apo konstatimi i Gjykatës së Apelit në lidhje me L. H. (shih paragrafët 15–17 dhe 41 më sipër) nuk

kanë asnjë ndikim në përfundimin e Gjykatës në lidhje me këtë aspekt. Së dyti, në lidhje me aq sa kërkuesi kundërshtoi përfundimet e Gjykatës së Apelit, Gjykata përsërit se nuk është detyra e saj që të zëvendësojë këndvështrimin e saj për atë të autoriteteve vendase. Duke pasur parasysh natyrën ndihmëse të sistemit të Konventës, nuk është funksioni i Gjykatës që të merret me gabimet e faktit apo të ligjit që pretendohen të jenë kryer nga një gjykatë vendase, për aq kohë sa nuk janë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa, dhe për aq kohë sa vlerësimi vendas nuk është arbitrar (shih *Vasilianskas kundër Lituanisë*, [DHM], nr. 35343/06, § 160, GJEDNJ 2015).

55. Në çështjen konkrete Gjykata nuk dallon ndonjë arbitraritet të tillë.

56. Kërkuesi parashtroi se nuk ekzistonte asnjë përkufizim juridik për municionet e kalibrit të vogël. Megjithatë, gjykatat vendase arritën në përfundimin, në procedurat e mbështetura mbi parimin e kontradiktorialitetit, se ishte brenda fushëveprimit të detyrës së tij si këshilltar që të këshillonte ministrin e Mbrojtjes se vendimi nr. 138 autorizonte çmontimin vetëm të municionit të kalibrit të vogël.

57. Në vijim, çështja tjetër ligjore për kërkuenin që duhej të adresohet ishte nëse SAC-i kishte kapacitetin që të trajtonte në mënyrë të sigurt municionin që ishte dhënë faktikisht për çmontim. Teksa vlerësimi fillestar i këtyre aspekteve mund të jetë kryer nga MEICO dhe oficerët ushtarakë, gjykatat vlerësuan se ishte detyra profesionale e kërkuetit që të sigurohej se – ose të paktën të bënte kërkime nëse – kontraktori privat i propozuar për procesin e çmontimit, sipas urdhrit nr. 2044, plotësonte kushtet juridike të kërkuara. Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për të arritur në përfundimin se një interpretim i tillë i ligjit përkatës vendas nga gjykatat e procedurave penale të ishte i paarsyeshëm ose në mospërputhje me thelbin e veprës së shpërdorimit të detyrës (shih *Saakashvili*, cituar më sipër, § 152).

58. Në lidhje me pretendimin për mungesë të elementit të dashjes, ndryshe nga parashtrimet e kërkuetit, konstatimi i gjykatave vendase se shpërthimi kishte qenë i paqëllimshëm, nuk është relevant me *mens rea* për sa i përket mosveprimeve të tij si kryekëshilltar juridik (në krahasim me neglizhencën e thjeshtë në përmbushjen e detyrës së tij). Edhe pse do të ishte e dëshirueshme që gjykatat vendase të kishin ofruar një arsyetim më të gjerë në lidhje me dashjen/qëllimin e tij, shkalla e shpërdorimit të detyrës nga ana e kërkuetit rezultoi të ishte e tillë që të shkonte përtej neglizhencës së thjeshtë.

59. Në përfundim, Gjykata konstaton se ekziston një bazë ligjore për dënimin e kërkuetit dhe për dënimin për shpërdorim detyre. Përfundimet e gjykatave vendase për elementet përbërse të veprës penale dhe konkretizimi i tyre në sjelljen e kërkuetit duhet të konsiderohen se janë pjesë e kompetencave të atyre gjykatave për të interpretuar dhe zbatuar ligjin vendas, dhe kërkueti, i cili ishte një zyrtar i nivelit të lartë në Ministrinë e Mbrojtjes, mund të kishte parashikuar se sjellja e tij do ta bënte atë përgjegjës penalisht sipas këtyre dispozitave.

60. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ankesa është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 16 tetor 2025.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE